

VENDIM
Nr. 274, datë 16.5.2018

**PËR KALIMIN NË PRONËSI NGA SHOQËRIA AEROPORTI “NËNË TEREZA” SHA,
TIRANË, TE SHOQËRIA “ALBCONTROL” SHA, TIRANË,
TË DY PASURIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi nga shoqëria Aeroporti “Nënë Tereza” sh.a., Tiranë, te shoqëria “Albcontrol” sh.a., Tiranë, të pasurive me nr. 6/57-N9, zona kadastrale 8350, vol. 18, f. 161, me sipërfaqe 317.10 (treqind e shtatëmbëdhjetë pikë dhjetë) m² dhe me nr. 6/57-N15, zona kadastrale 8350, vol.18, f. 162, me sipërfaqe 38.40 (tridhjetë e tetë pikë dyzet) m², Tiranë, me qëllim përfshirjen, si kapital i palës shtetërore, në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, për krijimin, administrimin dhe operimin e linjës ajrore kombëtare shqiptare “Air Albania”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, shoqëria “Albcontrol” sh.a., shoqëria Aeroporti “Nënë Tereza” sh.a. dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi